Koncesionet e Qirasë të Lidhura me Covid-19

Ndryshime në SNRF 16

Ndryshime në SNRF 16 *Qiratë*

Janë shtuar paragrafët 46A, 46B, 60A, C1A, C20A dhe C20B. Para paragrafit C20A është shtuar një titull i ri. Për lehtësi në lexim, këta paragrafë nuk janë nënvizuar.

Qiramarrësi

...

Matja

...

Matja e mëpasshme

...

Ndryshimet e qirasë

...

46A Për lehtësi praktike, një qiramarrës mund të zgjedhë të mos vlerësojë nëse është ndryshim qiraje një koncesion qiraje që plotëson kriteret në paragrafin 46B. Qiramarrësi që bën këtë zgjedhje do të trajtojë çdo ndryshim në pagesat e qirasë që vijnë nga koncesioni i qirasë njëlloj siç do të trajtonte ndryshimin duke zbatuar këtë Standard nëse ndryshimi nuk do të ishte ndryshim qiraje.

46B Lehtësia praktike në paragrafin 46A zbatohet vetëm për koncesionet e qirasë të ndodhura si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë covid-19 dhe vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet në vijim:

(a) ndryshimi në pagesat e qirasë sjell rishikim të shumës së qirasë e cila është në thelb e njëjtë ose më e vogël se shuma e qirasë që ishte para ndryshimit;

(b) çdo ndryshim në pagesat e qirasë ndikon vetëm pagesat e paracaktuara për t'u bërë më 30 qershor 2021 ose më parë (për shembull, një koncesion qiraje do të plotësonte këtë kusht nëse ai sjell pagesa qiraje më të vogla në datë 30 qershor 2021 ose më parë dhe pagesa qiraje më të mëdha për periudhat që shkojnë përtej datës 30 qershor 2021); dhe

(c) nuk ka ndryshim thelbësor në afatet dhe kushtet e qirasë.

...

Dhënia e informacioneve shpjeguese

...

60A Nëse një qiramarrës zbaton lehtësinë praktike në paragrafin 46A, qiramarrësi duhet të japë informacion:

(a) që e ka zbatuar lehtësinë praktike për të gjitha koncesionet e qirasë që plotësojnë kushtet në paragrafin 46B ose, nëse nuk e ka zbatuar për të gjitha koncesionet e tilla të qirasë, duhet të japë informacion mbi natyrën e kontratave ndaj të cilave ka zbatuar lehtësinë praktike (shih paragrafin 2); dhe

(b) për shumën e njohur në fitim ose humbje për periudhën raportuese për të pasqyruar ndryshimet në pagesat e qirasë që vijnë nga koncesionet e qirasë për të cilat qiramarrësi ka zbatuar lehtësinë praktike në paragrafin 46A.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Shtojca C

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

Data e hyrjes në fuqi

...

C1A *Koncesionet e qirasë të lidhura me Covid-19-*, i publikuar në maj 2020, shtoi paragrafët 46A, 46B, 60A, C20A dhe C20B. Qiramarrësi do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 qershor 2020 e në vijim. Lejohet zbatimi më i hershëm, duke përfshirë edhe pasqyrat financiare jo të autorizuara për publikim më 28 maj 2020.

Periudha kalimtare

...

Koncesionet e qirasë të lidhura me Covid-19 për qiramarrësit

C20A Qiramarrësi do të zbatojë *Koncesionet e qirasë të lidhura me Covid-19* (shih paragrafin C1A) në mënyrë retrospektive, duke njohur efektin e akumuluar të zbatimit fillestar të ndryshimit si rregullim në tepricën fillestare të fitimeve të pashpërndara (ose të ndonjë përbërësi tjetër të kapitalit, si të jetë më e përshtatshme) në fillim të periudhës vjetore të raportimit në të cilën qiramarrësi zbaton për herë të parë ndryshimin.

C20B Në periudhën raportuese në të cilën një qiramarrës zbaton për herë të parë *Koncesionet e qirasë të ldhura me Covid-19*, qiramarrësit nuk i kërkohet të japë informacionin shpjegues të kërkuar nga paragrafi 28(f) i SNK 8.

© Fondacioni i SNRF-ve